



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 26, datë 23.03.2020

"PËR

**MARRJEN E MASAVE NGA BASHKIA TIRANË PËR OFRIMIN E ASISTENCËS
NDAJ SHITESAVE NË NEVOJË NËPËRMJET PËRDORIMIT TË SASISË
USHQIMORE TË PAPËRDORUR NGA DREJTORIA E PËRGJITHSHME E
ÇERDHEVE DHE KOPSHTEVE"**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", nenit 24, nenit 29, pika 1, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, Vendimit nr.236, datë 19.03.2020 të Këshillit të Ministrave "Për marrjen e masave për ofrimin e asistencës në banesë ndaj shtresave në nevojë, në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga Covid-19", me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

- Marrjen e masave nga strukturat e Bashkisë Tiranë për ofrimin e asistencës ndaj shtresave në nevojë nëpërmjet ofrimit dhe shpërndarjes së pakove ushqimore në banesë në kuadër të masave të marra për mbrojtjen nga infeksioni COVID-19.
- Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve nisur nga pezullimi i frekuentimit të çerdheve dhe kopshteve në këtë periudhë, në mbështetje të kontratave që kanë me operatorët privat për blerjen e produkteve ushqimore, të evidentoj sasinë ushqimore që mund të vendos në dispozicion të Bashkisë Tiranë.
- Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve ngarkohet të marrë masat e nevojshme për evidentimin e sasisë ushqimore dhe vendosjen e tyre në dispozicion të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social, me qëllim shpërndarjen e tyre nëpër banesa të shtresave në nevojë.

- Në zbatim të këtij vendimi, me sasi ushqimore do të nënkuptojmë atë sasi ushqimore të papërdorur që nga momenti i mbylljes së çerdheve dhe kopshteve me urdhrat përkatës të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Kryetarit të Bashkisë Tiranë.
- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, koordinon me të gjithë strukturat përkatëse dhe grupet e ngritura për këtë qëllim, për ndjekjen e procesit të grumbullimit dhe shpërndarjes së pakove ushqimore.
- Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse ndjek procesin e grumbullimit dhe magazinimit të pakove ushqimore që do të vendosen në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve.
- Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

